



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.326 /2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë së Ashkalinve për Integrim (PAI), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinve të Kosovës (PDAK), dega në Ferizaj, për shkak të pengimit gjatë mbajtjes së fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia e Ashkalinve për Integrim (PAI), dega në Ferizaj.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 23.10.2013, nga subjekti politik PAI dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se më datë 13.10.2013 anëtarët e PDAK-së Qazim Rrahmani, Arben Shabani, Besart Jashari kanë penguar kandidatët dhe elektoratin e PAI-së në fshatin Dubravë gjatë fushatës zgjedhore. Pretenduesi thekson se kanë qenë të ofenduar me fjalë dhe kanë nxitur të tjerët për të na ofenduar dhe kanë hyrë në mesin e elektoratit me flamuj të PDAK-së, mirëpo policia ka ndaluar një gjë të tillë.

PZAP-i, e informoi subjektin politik Partia Demokratike e Ashkalinve të Kosovës (PDAK), në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013, në ora 12:00.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinve të Kosovës (PDAK) sipas afatit të caktuar, ku subjekti politik PDAK mohon pretendimet e ankuesit dhe thekson se gjatë mbajtjes së fushatës nga subjekti politik PAI në fshatin Dubravë, asnjëri nga të përmendurit në fjalë nuk kanë qenë në fshatin Dubravë. Personat në fjalë po atë ditë kanë qenë në një fushatë në Komunën e Prizrenit.

Përgjigjes tonë ia kemi bashkangjitur një fotografi dhe emrin dhe numrin e telefonit të njërit nga policët siç thuhet në përgjigje pjesëmarrës gjatë fushatës në fshatin Dubravë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të palës ankuese PZAP-i, i konsideron se janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara, sepse nuk ju është ofruar dëshmi bindëse nga parashtruesi i ankesës me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk mund të vërtetohet shkelja e supozuar. Andaj PZAP-i ,konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së,dhe nenit 115.1 lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 326/2013 më datën 25.10.2013



**Kryesuesi i Panelit**

**Nehat Idrizi**

#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*